

**AKT THEMELIMI**  
**i Shoqërisë "BHG- Bell Hospitality Group" Sh.p.k.**

Sot, më datë 01/02/2024,

- Z. Lorin Hoxha, shtetas shqiptar, lindur me 31/08/1999, në Tiranë, mbajtës i dokumentit Kartë Identiteti me Nr. personal J90831054L, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe Ligjit Nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për regjistrimin e biznesit", kanë vendosur të themelojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "BHG- Bell Hospitality Group" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1**  
**EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "BHG- Bell Hospitality Group" Sh.p.k.

**NENI 2**  
**SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresë: Apartamenti i ndodhur në Rrugën "Emin Duraku", me Nr. Pasurie 1/85, Zone Kadastrale 8270, Tiranë.

Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

**NENI 3**  
**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

**NENI 4**  
**OBJEKTI**

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Shërbim në fushën e Bar-Restorant.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themelues të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.



## **NENI 5**

### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i Ortakut themelues në vlerën 100.000 Lek (njëqind mijë) Lek dhe është i përbërë nga 1 (një) kuote.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Lorin Hoxha**, zotëron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 100.000 (njëqind mijë) Lek dhe 100.000 (njëqind mijë) Lek të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## **NENI 6**

### **ORGANET E SHOQËRISË**

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.  
**Z. Lorin Hoxha**, shtetas shqiptar, lindur me 31/08/1999, në Tiranë, mbajtës i dokumentit me Nr. personal J90831054L, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, zgjidhet si Administrator për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

## **NENI 7**

### **LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM**

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## **NENI 8**

### **DISPOZITA FINALE**

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë, duke autorizuar *Administratorin Z. Lorin Hoxha* për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

**ORTAKU THEMELUES**

**LORIN HOXHA**

